



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 94, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendin e Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 4, paragrafi 4, të vendimit nr. 3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të votave”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, cakton me vendim Vendin e Numërimit të Votave të çdo ZAZ-je.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar Prefektëve të Qarqeve, me shkresat përkatëse, duke ju sjellë në vëmendje afatin ligjor për paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut përkatës, të cilët përmbushin kriteret e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në vendimin nr. 3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

Prefektët e 12 (dymbëdhjetë) qarqeve, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 94, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur në KQZ listën e objekteve brenda territorit të qarkut përkatës. Për çdo objekt është referuar mjedisi ku mund të caktohet VNV-ja dhe është paraqitur planimetria e tij.



Nga shqyrtimi i të dhënave të objekteve të paraqitura nga prefektët, rezulton se objektet dhe mjediset përkatëse përmbushin kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr.3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave” si vijon:

- janë salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive;
- plotësojnë kriterin teknik të sipërfaqes bazuar në numrin e QV-ve të ZAZ-së;
- përgjithësisht, janë brenda territorit të ZAZ-ve;
- ofrojnë lehtësi logjistike të transportit rrugor nga QV-të e ZAZ-së;
- ofrojnë kushte për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave;
- kanë sistem të pandërprerë të furnizimit me energji elektrike.

Prefekti i qarkut Dibër në propozimin e tij ka paraqitur për Bashkinë Klos dy ambiente për VNV:

- i) Ambienti privat i z. Nazmi Tusha (ambient i ri i propozuar. Në zgjedhjet e vitit 2021 ka qenë e vendosur në ambientin privat të z. Gjyljano Dedolli).
- ii) Palestra e shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.

Bashkia Klos referon shqetësim për vënien në dispozicion të palestrës me arsyen e dëmtimit pasi është një investim i ri dhe sapo është marrë në dorëzim.

Administrata e KQZ ka kryer verifikim në terren dhe ka konstatuar se palestra e shkollës është funksionale, e sapo rikonstruktuar dhe është me e favorshme për zhvillimin e procesit të administrimit zgjedhor.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Erion META	Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Majlinda ÇELMETA	Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Ylli MERKAJ	Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:03.2023

Nr:

Ora::....

PROJEKTVENDIM

PËR

**CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 93, pika 1 dhe nenit 94 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Qarku	KZAZ	Nr. QV	Objekti i propozuar per VNV	Siperfaqja
Shkoder	01	71 QV	Palestra Shkolles "Avdyl Bajraktari"	650 m2
	02	107 QV	Pallati Sportit "Qazim Dervishi"	650 m2
	03	47 QV	Palestra Shkolles "Shenjaze Juka"	300 m2
	04	46 QV	Palestra pranë Shkolles 9-vj "Ismail Qemali"	250 m2
	05	47 QV	Palestra Shkolles "Xheladin Fishta"	500 m2
	06	53 QV	Palestra Shkolles Profesionale, Bushat	300 m2
	07	20 QV	Pallati Sportit prane Shkolles se mesme "Sabah Sinani"	783 m2
	08	16 QV	Palestra e shkolles "Pjeter Arbnori"	199.5 m2
Kukes	09	38 QV	Pallati Sportit Valbona, B.Curri	520 m2
	10	28 QV	Palestra e Gjinnazit "Skënderbeu", Krumë	364 m2
	11	73 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit"	272 m2
Lezhe	12	59 QV	Shkolla e mesme "Hydajet Lezha"	270 m2
	13	67 QV	Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja"	270 m2
	14	48 QV	Pallati I sportit "Arjana Arapi "	496 m2
	15	74 QV	Shkolla e mesme "At' Shtjefën Gjeçovi"	288 m2
Diber	16	49 QV	Pallati Sporti "Ferid Hysa"	600 m2
	17	27 QV		
	18	49 QV	Pallati Kultures, Salla e Teatrit	331.5 m2
	19	99 QV	Palestra e shkolles se mesme "Nazmi Rushiti"	300 m2

Qarku	KZAZ	Nr. QV	Objekti i propozuar per VNV	Siperfaqja
Durrës	20	91 QV	Salla e kulturës e Bashkisë Krujë	300 m2
	21	110 QV	Pallati i Sportit "Ramazan Njala"	560 m2
	22	81 QV	Palestra e shkollës "Marie Kaçulini"	350 m2
	23	77 QV	Palestra e shkollës "Jan Kukuzeli"	480 m2
	24	74 QV	Palestra e shkollës "Leonik Tomeo"	450 m2
Tiranë				
	26	44 QV	Shkolla 9-vjeçare Vorë, Palestra	500 m2
	27	89 QV	Shkolla 9-vjeçare "Hillary Clinton"	700 m2
	28	44 QV	Gjimnazi "Isa Boletini", Palestra	560 m2
	29	108 QV	Palestra e shkolles 9-vjeçare, Katund i Ri	310 m2
	30	92 QV	Palestra e shkolles 9-vjeçare, "1 Maj"	500 m2
	31	56 QV	Palestra e shkolles 9-vjeçare, "Kushtrim i Lirisë"	200 m2
	32	90 QV	Palestra, Shkolla "Hasan Tasim"	440 m2
	33	52 QV	Palestra, Shkolla mesme "Andon Zako Çajupi"	350 m2
	34	73 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Bajram Curri"	250 m2
	35	94 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Vasil Shanto"	500 m2
	36	70 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Betim Muço"	200 m2
	37	84 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Gustav Mayer"	320 m2
	38	51 QV	Palestra, Shkolla e Kuqe	390 m2
	39	70 QV	Muzeu Historik Kombëtar	300 m2
	40	31 QV	Palestra, Shkolla mesme "Qemal Stafa"	580 m2
	41	68 QV	Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Ahmet Gashi"	370 m2
	42	92 QV	Palestra, Shkolla mesme "26 Marsi"	310 m2
	43	55 QV	Gjimnazi "Haxhi Qehaj"	220 m2

Qarku	KZAZ	Nr. QV	Objekti i propozuar per VNV	Siperfaqja
Elbasan	44	46 QV	Salla kryesore e Pallatit te Kultures	200 m2
	45	39 QV	Palestra e gjimnazit, Belsh	305 m2
	46	58 QV	Palestra e shkolles "Aleks Buda"	190 m2
	47	101 QV	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"	331 m2
	48	45 QV	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"	331 m2
	49	39 QV	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"	331 m2
	50	38 QV	Palestra e shkolles Jorgji Dilo"	710 m2
	51	48 QV	Pallati i Sportit, Gramsh	1350 m2
	52	54 QV	Palestra e gjimnazit, "Ibrahim Muça"	1008 m2
	53	38 QV	Palestra e shkolles "Halit Bërzeshita"	300 m2
Fier				
	54	92 QV	Palestra e shkolles "Skender Libohova"	504m2
	55	64 QV	Holli i Muzeut Historik, Lushnje	200 m2
	56	67 QV	Qendra Kulturore, Divjake, kati i dyte	208.6 m2
	57	63 QV	Palestra e shkolles "Petro Sota"	205 m2
	58	64 QV	Palestra e shkolles "Jakov Xoxa"	350 m2
	59	97 QV	Palestra e shkolles "Janaq Kilica"	591 m2
	60	47 QV	Salla e konferencave te Pallatit Kultures, kati i dyte Patos	160 m2
	61	39 QV	Salla e shfaqjeve ne Pallatin e Kultures, Roskovec	176 m2
	62	50 QV	Palestra e shkolles "Dervish Hekali"	495 m2
Berat				
	63	49 QV	Qendra Kulturore	294 m2
	64	65 QV	Qendra kulturore e femijeve "Kristaq Laçka"	320 m2
	65	72 QV	Qendra kulturore e femijeve ""Margarita Tutulani"	363 m2
	66	45 QV	Biblioteka "Vehxhi Buharaja"	760 m2
	67	22 QV	Pallati i Kultures Poliçan	120 m2
	68	23 QV	Salla e kinemase "Tefik Lepani"	160 m2

Qarku	KZAZ	Nr. QV	Objekti i propozuar per VNV	Siperfaqja
Korce	69	106 QV	Palestra në Gur të Kuq (Ish Fani)	1008 m2
	70	76 QV	Palestra e Shkolles se Mesme te bashkuar "Dhimitraq Gjata"	310 m2
	71	8 QV	Palestra e Shkolles se Mesme të Bashkuar, kati I	120 m2
	72	49 QV	Qendra Kulturore e Femijeve	300 m2
	73	55 QV	Palestra e Shkollës së Mesme "Raqi Qirinxhi"	460 m2
	74	103 QV	Pallati i sportit "Tamara Nikolla"	1170 m2
	75	28 QV	Biblioteka e qytetit "Skender Luarasi"	150 m2
Gjirokaster				
	76	23 QV	Pallati i Sportit, Përmet	400 m2
	77	18 QV	Palestra Shkolles "Sejfulla Maleshova"	200 m2
	78	27 QV	Pallati Kultures Memaliaj	150 m2
	79	21 QV	Pallati Kultures Tepelene	150 m2
	80	67 QV	Pallati Sportit Gjirokaster	848 m2
	81	9 QV	Pallati Kultures Libohove	210 m2
	82	37 QV	Shtepia e Kultures Grapsh	360 m2
Vlore				
	83	66 QV	Palestra e shkolles 9-vjeçare "Ismail Qemali"	456 m2
	84	51 QV	Pallati Sportit "Flamurtari"	1600 m2
	85	52 QV	Palestra e shkolles "Ali Demi"	540 m2
	86	55 QV	Pallati Sportit "Flamurtari"	1600 m2
	87	42 QV	Palestra shkolles 9 vjecare "Eqerem Beqiri", Kote	560 m2
	88	36 QV	Godina e fushes se Sportit, Palestra	184 m2
	89	22 QV	Kinoteatri i Qytetit Delvine	220 m2
	90	52 QV	Palestra e shkolles mesme "Antoni Athanas"	276 m2
	91	50 QV	Qendra Kulturore "Katina Papa", Livadhja	400 m2
	92	16 QV	Palestra e shkolles mesme "Bido Sejko"	350 m2



